



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-001

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala L.K., kundër gjyqtarit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, A.H., më datë 29.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e L.K., kundër gjyqtarit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, A.H..

A r s y e t i m

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren më 3 janar 2024, konform nenit 9 par.2 të Ligjit nr. 06/L -057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka përcjellë ankesën e palës e L.K., kundër gjyqtarit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, A.H..

Pala ankuese, në ankesën e tij ka paraqitur pretendimet e tij, se gjyqtari A.H., në Gjykatën Themelore në Prizren në çështjen juridike të përmbarimit, nuk ka përfillur padinë e paditëses së kompanisë rajonale të ujitjes “Radoniqi Dukagjini” në Gjakovë. Pala pretendon se është faturuar në mënyrë të jashtëligjshme për ujitje në zonën kadastrale K. vogël, derisa me listën poseduese si dhe në kartelën e konsumatorit është e vërtetueshme se pronarë për atë zonë kadastrale janë D. dhe N.K.. Lidhur me këtë, sipas palës, gjyqtari A.H., në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditores K.R.M “Radoniqi – Dukagjini” kundër debitorit L.K., për përmbarimin e dokumentit sipas palës ankuese kinse i besueshëm, me nr. Am 5... të datës 25.09.14, në mënyrë të kundërligjshme ka marr aktvendim përmes së cilit prapësimi i ushtruar nga pala kundër urdhrin për përmbarim është hedhur si i pa afatshem.

Me qëllim të vërtetimit të këtyre pretendimeve, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka kërkuar nga gjyqtari A.H., të deklarohet lidhur me këtë rast dhe ka pranuar deklaratën e të njëjtit.

Në deklaratën e tij, gjyqtari A.H., theksoi se pas caktimit në çështje përmbarimore, ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për procedimin e lëndëve të përmbarimit, përfshirë edhe lëndën e palës ankuese. Tutje në deklaratën e tij, thuhet se konsideron se nuk qëndron asnjë bazë ligjore sipas Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për ankesën e paraqitur

nga pala, sepse pa dallim të palëve ka respektuar çdo afat ligjor lidhur me secilën lëndë dhe se ka qenë i përkushtuar për kryerjen efikase dhe efektive të lëndëve, përfshirë lëndën përmbartimore në fjalë.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së gjyqtarit, si dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës, vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës si dhe nga të gjitha pretendimet e palës ankuese, rezulton se kemi të bëjmë me shprehje të pakënaqësisë rreth vendimeve të marra gjatë procedurës, nga ana e gjyqtarit të çështjes. Në këtë drejtim, si autoritet kompetent nuk është në kompetencën time të vlerësoj mënyrën e vendosjes së gjyqtarëve dhe vendimit të marrë nga gjyqtari i çështjes, ngase gjyqtarët por edhe Kryetari i Gjykatës janë të pavarur në ushtrimin e funksionit të tyre respektivisht në punën e tyre.

Bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet se: *“Gjyqtarët gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe veprimet tjera që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre si gjyqtar”*, në rastin konkret konsideroj se veprimet e gjyqtarit në raport me lëndën konkrete nuk përbëjnë bazë për dyshim për ndonjë sjellje të mundshme disiplinore.

Duke u bazuar në këto, kryetari i Gjykatës Supreme vlerëson se një ankesë e tillë në bazë të këtyre pretendimeve është e pabazuar, për faktin se çështja e cila është objekt i ankesës, është çështje e gjykuar dhe se nuk kemi asnjë element të shkeljeve disiplinore.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtarit të DhPGjS.
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.